



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Raporti Vjetor IADK 2011



Për IADK-në viti 2011 ka qenë i suksesshëm në të gjitha drejtimet. IADK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me fermerët e Kosovës dhe shoqatat e tyre, organizatat tjera joqeveritare, komunat dhe autoritetet qeveritare, duke i kushtuar rëndësi diversitetit dhe gjithëpërfshirjes në aktivitetet e saj.

Si organizatë e përbërë nga një staf profesional, IADK angazhohet për të kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese të fermerëve, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg, të shpërndajë njohuri për praktikën më të mira të prodhimit bujqësor dhe të përpunimit shtëpiak duke lobuar për politika dhe projekte që i kontribuojnë zhvillimit rural në Kosovë sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

IADK per here te pare ne kete vit ka zgjeruar partneritetin edhe me Church of Sweden (CoS), Swiss Cooperation Office – Kosovo (SDC) dhe USAID/NOA (New Opportunities for Agricultural)

Gjatë këtij viti me ndihmën e Bashkimit Evropian, IADK ka ngritur katër pika demonstruese bujqësore që shërbejnë si model për farmingun e avancuar. Këto pika janë **një fermë model** me sistem të mbajtjes së lirë të kafshëve e pajisur me aparaturën e nevojshme të një ferme moderne, **një pemishte intensive e mollës** me sipërfaqe 1 hektarësh, **një serrë 500m²**, me inpute, sistem të ngrohjes dhe **një pikë përpunuese të frutave** e pajisur me aparaturën moderne të përpunimit dhe paketimi të produkteve të ndryshme nga frutat e perimet. Poashtu ka vazhduar ndihmën ndaj fermerëve përmes projekteve të financuara nga donatorët tradicionalë EED, FCA dhe partnerve PUM dhe AFDI.

Për punën dhe angazhimin e IADK-së kanë meritë të madhe donatorët, partnerët dhe sponsorët tanë të ndryshëm për mbështetjen dhe ndihmën e tyre të pakursyer. Punën tonë e bën më të lehtë edhe angazhimi dhe korrektësia e fermerëve për të zbatuar në praktikë njohuritë e fituara nga këshillat apo nga trajnimet e organizuara nga ekspertët tanë.

Për IADK-në edhe më tutje mbetet prioritet ngritja e njohurive dhe përdorimi i teknikave dhe pajisjeve të reja teknologjike tek fermerët dhe perfituesit e programeve tona me qëllim të ngritjes së prodhimtarisë, cilësisë, sasisë dhe për uljen e kostos së prodhimit.

IADK beson që me një bashkëpunim të ngushtë të ekipit profesional të IADK-së, fermerëve, komunave, MBPZHR si dhe partnerëve ndërkombëtar do të arrijmë të prodhojmë ushqim të cilësisë së lartë dhe të kontribuojmë në zvoglimin e importit dhe hapjen e vendeve të punës.

Zenel Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv

Partneret qe kane mbështetur projektet e IADK-se gjate vitit 2011

- FinChurcAid/Government of Finland (FCA/GoF)
- Evangelischer Entwicklungsdienst, Germany (EED)
- Church of Sweden (CoS)
- European Commission Liaison Office to Kosovo (ECLO)
- Swiss Cooperation Office – Kosovo (SDC)
- USAID/NOA (New Opportunities for Agricultural)

Shtrirja e aktiviteteve:

Komunat Mitrovicë, Vushtri, Skënderaj, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Drenas dhe Podujevë. Me projektin e SDC dhe USAID/JOA në tërë Kosovën.

Departamentët kryesore të IADK-së janë:**Blegtoria,**

Ku përfshihen gjedhet delet dhe dhit prodhimi dhe përpunimi i qumeshtit, ushqimi për kafshë, përmirësimi racor dhe mekanizmi bujqësor.

Hortikulture

Pemët, ku përfshihen mollat, kumbullat, dredhëza, mjedra dhe manaferra

Perimet, ku përfshihen kultivimi i domates, specit, trangujt, sallatat, spinaqit dhe kultivimi i fidanëve të perimeve në serra.

Frutat pyjore dhe bimët mjekuese ku përfshihet grumbullimi dhe tharja e frutave malore dhe bimëve mjekuese

Përpunimi i ushqimit shtëpiak, ku përfshihen përpunimi i qumështit, pemëve dhe perimeve, organizimi i grave në shoqata.

Brenda çdo departamenti ekipet tona synojnë që:

- Fermerët të rrisin aftësitë konkurruese në treg
 - Të zvogëlojnë mbështetjen e materialeve të importuara në sektorin e bujqësisë
 - Të përmirësojnë mjedisin në të cilin veprojnë fermerët, duke ju krijuar infrastrukturë më të mirë prodhuese dhe përpunuese.
 - Në bashkëpunim me institucionet përkatëse të bëjnë harmonizimin e ligjeve të bujqësisë.
-

Përfituesit e programit per vitin 2011

- 83 Familje kanë përfituar direkt nga programi:** pajisje per ftohjen e qumështit, mekanizëm bujqësor, sitem te mjeljes se lopeve dhe pajisje tjera per ferma, makina mjelese, pajisje per përpunimin e qumështit te dhise, serra me sistem te ngrohjes, fidanë dhe inpute për ngritjen e pemishteve me mollë, fidane dhe inpute për ngritjen e pemishteve me kumbull, fara dhe inpute per kultivimin e kornishonit, pajisje për grumbullimin e frutave pyjor, pajisje per përpunimin e perimeve, pajisje per perpunimn e pemeve dhe paketime te ndryshme.
- 173 Fermere, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së,** kanë marrë pjesë në 13 vizita në: Kosovë (6) Maqedoni (3), Shqipëri (3), dhe Francë (1)
- 2093 Fermerë,** kanë marrë pjesë në 172 sesione të trajnimeve
- 31 Sesione të trajnimeve në sektorin e Blegtorisë,** 345 pjesmarrës kanë marrë pjesë.
- 74 Sesione të trajnimeve në sektorin e Hortikulturës,** 983 pjesmarrës kanë marrë pjesë.
- 145 Sesione të trajnimeve në sektorin e Përpunimit Shtëpiak,** 145 pjesmarrëse kane marrë pjesë.
- 49 Sesione të trajnimeve janë mbajtur në sektorin e Menaxhimit të Bisneseve,** 613 pjesmarrës kanë marrë pjesë.
- 1 Panair Regjional i Bujqësisë -** mbi 106 fermerë ekspozuan produktet e tyre
- 1 Dita e Dredhëzes -** 48 fermerë kane marre pjesë me produktet e tyre
- 3 Publikime praktike,** 3 broshura x 1000 kopje (përpunimi i pemëve kultivimi i molles dhe te ushqyerit e deleve dhe qengjave)
- 3 Partnerë ndërkombëtar,** AFDI, PUM, FFRM
- 13 Lajme gazetash** kanë shkruar për aktivitetet IADK-në
- 5 Televizione kombëtare kanë prezantuar 9 herë aktivitetet e IADK-së**

Stafi i IADK-së ka kontribuar nëpërmjet grupeve të ndryshme punuese në përgatitjen e strategjive, ligjeve, kritereve etj., të cilat janë organizuar nga institucionet dhe organizatat lokale, regjionale dhe kombëtare.

DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

Ndërtimi i model fermës për lopë qumështore

Shumica e fermave të lopëve dhe kafshëve tjera në përgjithësi në Kosovë nuk i plotësojnë kriteret e caktuara për mbajtjen e kafshëve. Edhe pse kohëve të fundit kanë filluar të ndërtohen ferma të reja, fermerët janë duke bërë gabime në ndërtimin e fermave të cilat nuk i plotësojnë standardet të cilat kërkohen për mbarështimin e kafshëve.

Për të ju ndihmuar fermerëve dhe palëve tjera të interesuara, IADK ka bërë ndërtimin e model fermës me sistem të lirë të mbajtjes së lopëve qumështore me kapacitet prej 20 lopëve sipas standardeve evropiane. Model ferma e lopëve është duke shërbyer si model për fermerët tjerë; si qendër demonstruese për fermerët e regjionit të Mitrovicës dhe më gjerë.



Ndërtimi i model fermës është bërë sipas standardeve evropiane me kapacitet prej 20 lopëve qumështore. Model ferma posedon dhomën mjelëse, dhomën për ruajtjen dhe ftohjen e qumështit, zyrën për stafin e fermës dhe pjesët tjera përcjellëse. Model ferma është pajisur me këto pajisje si: sistemin automatik të mjeljes (4 lope në një mjelje), laktofrizin me kapacitet 1400 litër, boksat dhe gomat për qëndrimin e lopëve, boksat për ushqimin e lopëve, skreperët automatik për largimin e plehut, ujë pirëset automatike dhe pajisjet tjera përcjellëse të fermës. Për të menaxhuar sa më mirë model fermën me sistem të lirë të mbajtjes së lopëve, IADK ka bërë trajnimin e punëtorëve në aspektin e menaxhimit të fermës; ku menaxheri i fermës është dërguar për vizitë studimore (10 ditë) në Francë dhe është trajnuar në aspektin praktik të menaxhimit të fermave qumështore.



Në mënyrë që praktikatat e mira të shpërndahen në nivel më të gjerë, IADK ka themeluar tri grupe të fermerëve nga komunat e Vushtrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt. Me secilin fermer IADK ka nënshkruar kontrata ku IADK do të trajnojë fermerët në 10 tema të trajnimit në aspektin profesional të blegtorisë dhe në 7 tema në aspektin e menaxhimit të fermave. Gjate këtij viti IADK ka mbajtur

5 tema të trajnimit ku janë trajnuar 52 fermerë të regjionit të Mitrovicës. Pas trajnimit dhe aplikimit të njohurive të reja prodhimtaria e qumështit është rritur në 10 % kurse 27% e pjesëmarrësve në trajnime kanë përmirësuar kualitetin e qumështit dhe 12 % e fermerëve kane përmirësuar infrastrukturën ne fermat e tyre.

Përpunimi i qumështit të dhisë

Duke parë që produktet nga qumështi i dhisë janë të kërkuara dhe tregu ka nevojë për prodhime cilësore, IADK gjatë vitit 2011 ka ndihmuar ne ngritjen e qenders per përpunimin e qumështit te dhisë. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është rritja e kapacitetit përpunues i qumështit të dhisë, përmirësimi i kualiteti te produkteve të qumështit dhe të rritet vlera e produkteve finale. Qendra përpunuese e qumështit të dhisë është ngritur në fshatin Bajgorë komuna e Mitrovicës dhe është pajisur me të gjitha pajisjet për përpunimin e qumështit me një kapacitet prej 500 litrash.



Duke pasur parasysh mungesën e përvojës në përpunimin e qumështit të dhisë, IADK ka bërë trajnimin e stafit të qumështores në përpunimin e qumështit në lloje të ndryshme të djathërave. Trajnimet janë mbajtur nga ekspertë nga Holanda, Franca, Maqedonia dhe ekspertë vendor. Trajnimet janë mbajtur direkt në qumështore ku stafi i qumështores është trajnuar në përpunimin e katër llojeve të djathërave,



në zvogëlimin e koston së prodhimit të djathit dhe në përmirësimin e kualitetit të qumështit. Pas trajnimit dhe lëshimit në funksion të pajisjeve, përfituesi ka filluar në prodhimin këtyre llojeve të djathërave si: djathë të bardhë, djathë gauda, djathë francez, djathë me perime, përpunimin e gjizës dhe në përpunimin e qumështit dhe prodhimeve tjera te qumeshtit. Pas futjes në prodhim të pajisjeve dhe trajnimit të stafit të qendrës përpunuese të djathit te dhisë është arritur të ulët kostoja e prodhimit të djathit, ku para përdorimit të pajisjeve dhe recepturave që ka përdorur para trajnimit, raporti

qumësht/djathë ka qenë 10:1, ndërsa me përdorimin e teknologjive dhe recepturave të reja është arritur të ulet ky raport në 6.5 litër qumësht për një kg djathë të bardhë. Kostoja e prodhimit të djathit të bardhë është ulur rreth 35%. Po ashtu kjo ka reflektuar edhe në kualitetin e prodhimeve të qumështit dhe të rrite vlerën e produktit prej 4 €/kg në 5€/kg djathë të bardhë.

Qendra demonstruese e përpunimit të qumështit është duke u përdorur edhe si qendër trajnuese për fermerët tjerë, ku grupet e grave nga regjioni i Mitrovicës, studentët nga Fakulteti i Teknologjisë në Mitrovicë dhe fermerë tjerë janë trajnuar në përpunimin e qumështit në aspektin praktik.

Instalimi i pajisjeve ftohëse të qumështit në fermë

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që të përmirësohen kushtet e fermës e në veçanti të përmirësohet kualiteti i qumështit të freskët nga fermerët. Duke parë se një ndër problemet kryesore në përmirësimin e kualitetit të qumështit është se fermerët nuk kane pajisje adekuate për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit, IADK ka përkrahur dy fermerë me pajisje për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit. Tek të dy përfituesit është rregulluar dhoma për vendosjen e pajisjeve sipas standardeve që kërkohen; në secilën pikë janë instaluar laktofrizat me kapacitet nga 1000 litra, pompat për transportimin e qumështit nga laktofrizi në cisternën për grumbullim të qumështit, brushat adekuate për pastrim, acid dhe bazë për pastrim të laktofrizave, pajisje për analizat kimike të qumështit (Ekomilk) dhe rregullator të rrymes në secilën pikë.



Pas instalimit të pajisjeve, fermerët janë trajnuar në pesë tema të trajnimit mbi përdorimin e pajisjeve, përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe menaxhimin e fermave qumështore. Trajnimet janë mbajtur në pikat grumbulluese të qumështit dhe direkt në ferma, në secilën pikë janë trajnuar 16 fermerë tjerë të cilët dorëzojnë qumësht në keto pika.

Pas trajnimit dhe testimit të pajisjeve, fermerët kanë filluar me grumbullimin e qumështit dhe gjatë këtij viti 16 fermerë janë duke dorëzuar qumësht, ku sasia e përgjithshme mujore e grumbullimit të qumështit është rreth 24800 litër

qumësht/muaj. Mesatarja e të hyrave nga shitja e qumështit për fermerë në muaj është rreth 529 €/muaj. Po ashtu përmirësimi i kualitetit të qumështit është përmirësuar rreth 20 %.

Shpërndarja e makinave mjelëse

Në kuadër të aktiviteteve në sektorin e blegtorisë, IADK rendësi të veçantë i ka dhënë përmirësimit të kualitetit të qumështit dhe përmirësimit të kushteve në ferme. Në kuadër të kësaj IADK ka përkrahur 8 fermerë me raste sociale nga komuna e Vushtrrisë dhe Skënderajt me nga një makine mjelëse për lopë. Katër përfitues janë nga komuniteti shqiptar dhe katër përfitues janë nga komuniteti serb. Te gjithë përfituesit janë trajnuar në përdorimin e makinave mjelëse dhe në përmirësimin e kualitetit të qumështit.



Përfituesit e makinave mjelëse për lopë

Vizita studimore në shkëmbimin e përvojave

Vizita në Maqedoni - Me qëllim të shkëmbimit të përvojave në mes të fermerëve të regjionit të Mitrovicës me fermerët nga Maqedonia, IADK gjatë vitit 2011 në sektorin e blegtorisë ka organizuar një vizitë studimore me fermerët e deleve dhe dhive në Maqedoni. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët të njihen me praktikën e reja në aspektin e menaxhimit të fermave, përpunimin e qumështit të deles dhe dhisë, organizimin e fermerëve në shoqata dhe prodhimet bio të produkteve të deleve dhe dhive. Vizita studimore ka zgjatur 3 ditë dhe kanë marrë pjesë 10 fermerë nga regjioni i Mitrovicës.

Vizita në Shqipëri – Gjatë vitit 2011, IADK ka organizuar vizitë studimore në disa ferma blegtorale të Shqipërisë. Gjatë kësaj vizite kanë marrë pjesë 11 fermerë nga regjioni i Mitrovicës. Qëllimi i vizitës ka qenë që fermerët të njihen me: fermat blegtorale në Shqipëri të madhësive të ndryshme që merren me menaxhimin e gjedhit, eksperiencën shqiptare mbi zhvillimin e inseminimit

artificial ne gjedhe, me njohjen e metodave të thjeshta të përpunimit të qumështit, dhe me eksperiencën shqiptare mbi standardet e prodhimit dhe të higjienës, Gjatë kësaj vizite janë vizituar ferma për prodhimin e qumështit, përpunues të qumështit dhe janë realizuar takime me shoqatën e blegtorëve Shqiptar LEAA si dhe shoqatën për përpunimin e qumështit dhe mishit ADAMA. Gjatë këtyre vizitave dhe takimeve pjesëmarrësit kanë marrë përvoja të reja si në ushqyerit e lopëve me sistem të lire të mbajtjes së lopëve, inseminimit artificial, higjienën e qumështit, rritjen e mëshjtjerrave për reproduksion, organizimin e tregut në Shqipëri.

Organizimi i vizitës së fermerëve nga Maqedonia në Kosovë

Gjate muajit Qershor 2011, IADK ka organizuar vizitë studimore në Kosovë për fermerët nga Maqedonia. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë pesë fermerëve prodhues të qumështit. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët nga Maqedonia të njihen me eksperiencat e fermerëve Kosovarë dhe të behet shkëmbimi i përvojave të tyre. Gjatë kësaj vizite janë vizituar fermerë të ndryshëm ku gjatë vizitave fermerët nga Maqedonia kanë pasur rastin të njihen me standardet dhe kriteret për kualitet të qumështit në Kosovë, mënyrën e grumbullimit të qumështit, të ushqyerit e lopëve dhe menaxhimin e fermave të lopëve qumështore.

Aktivitete me partnerët e jashtëm

IADK gjatë vitit 2011 ka nënshkruar dy marrëveshje 3 vjeçare të bashkëpunimit me dy shoqata internacionale në sektorin e bujqësisë, PUM nga Holanda dhe AFDI nga Franca. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit është në realizimin e projekteve të përbashkëta në edukimin e fermerëve, kompanive përpunuese të ushqimit dhe institucioneve tjera të cilat merren me bujqësi.

Organizata AFDI nga Franca

AFDI është shoqatë nga Franca me seli nga regjioni i Normandisë së ulët e cila prej vitesh bashkëpunon me IADK. Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me qëllim të shkëmbimit të përvojave për të arritur një ngritje profesionale të fermerëve në sektorin e blegtorisë.

Gjatë vitit 2011 përfaqësuesit e AFDI-t kanë realizuar dy vizita në Kosovë me qëllim që t'u ndihmohet fermerëve në menaxhimin sa më të mirë të fermave në rritjen e produktivitetit dhe uljen e kostos së prodhimeve blegtorale. Gjatë këtyre vizitave janë trajnuar rreth 30 fermerë të lopëve dhe dhive.

Ndërsa gjatë këtij viti IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë ku kanë marrë pjesë tre fermerë nga regjioni i Mitrovicës. Vizita ka zgjatur 10 ditë dhe qëllimi kryesor i vizitës ka qenë që fermerët të njihen me teknologjitë e reja në sektorin e blegtorisë, organizimin e fermerëve në shoqata, menaxhimin e fermave qumështore dhe rregulloret për kualitet të qumështit.

Publikimet

Ne sektorin e blegtorisë gjatë vitit 2011 është bërë publikimi i broshurës së deleve “Të ushqyerit dhe menaxhimi i deleve dhe qengjave”. Broshura është e pasur me material praktik për nevojat e fermerëve e cila është e ilustruar edhe me fotografi. Broshura është botuar në 1000 kopje ku u është shpërndarë fermerëve, komunave dhe institucioneve tjera të cilat merren me bujqësi.



Organizimi i tryezës së rrumbullakët

Gjatë këtij viti IADK mbajt tryezën e rrumbullakët mbi temën “Mundësitë e Zhvillimit të Sektorit të Deleve dhe Dhive në Regjionin e Mitrovicës” në të cilën kane marrë pjesë përfaqësues të komunave, Ministrisë së Bujqësisë, AVUK-ut, veterinarë e fermerë nga regjioni i Mitrovicës. Në fund të takimit pjesëmarrësit kanë dhënë konkluzione dhe rekomandime për zhvillimin e këtij sektori.

DEPARTAMENTI I HORTIKULURËS

Përpunimi i frutave

Në mungesë të industrisë përpunuese të prodhimeve bujqësore, fermerët e regjionit të Mitrovicës shpeshherë kanë vështërsi në shitjen e prodhimeve të tyre ose kanë përfitime shumë të vogla nga çmimet e ulta të shitjes. Kështu ata dhe vijnë në dilemë për të rritur apo jo sipërfaqet me pemë e perime. Po ashtu një pjesë bukur e mirë e prodhimeve bujqësore jo të klasës së parë për nga cilësia tregtare, hudhen për shkak se nuk ka kapacitete të përpunimit të tyre.

Për të zbutur sado pak këto vështërsi të fermerëve, e me qëllim të shtimit të vlerës së produkteve të tyre bujqësore, këtë vit IADK-ja ka mbështetur një fermer në fshatin Klinë e Epërme të Skenderajt me pajisjet e nevojshme për ta ngritur Qendrën Përpunuese të Frutave të Imëta.



Për vënie në funksion të pajisjeve dhe aftësimin profesional të stafit të kësaj qendre përpunuese janë organizuar sesione praktike të trajnimeve, nga ekspert të teknologjisë përpunuese. Në këtë aspekt janë mbajt 11 sesione të trajnimeve ku

janë përgatitur dhe demonstruar recepturat për 7 produkte të ndryshme: xhem kumbulle, pekmez kumbulle, xhem manafërre, xhem dredhëze, marmelatë molle dhe kumbulle, keqap, ajvar.

Në bashkëpunim me përfituesin dhe një kompani profesionale janë përgatitur tiketat dhe llojoja e produkteve të përpunuara.

Qendra përpunuese ka grumbulluar lëndën e parë/frutat pemëve e perimeve nga 14 fermerë ku janë grumbulluar 5843kg prej tyre: 5053 kg kumbullë, 200 kg manaferrë, 130 kg dredhëz, 200 kg mollë 230 kg spec dhe 30 kg domate. Nga kjo punë është arrit të përpunohen 2800 kg produkte të ndryshme. Projekti ka përkrahur angazhimin e një eksperti i cili ka trajnuar stafin e pikës përpunuese, stafin e Departamentit të Përpunimit të IADK-së dhe gratë e regjionit në përgatitjen e 18 llojeve të produkteve të përpunuara (xhem, marmelatë, ajvar, keqap, reçel, pekmez etj). Këtu janë trajnuar 33 gra të regjionit të Mitrovicës për përpunimin e frutave. Më 23 Nëntor IADK organizoi promovimin e kësaj pike. Në këtë ceremoni morën pjesë Ministri i Bujqësisë z.Blerand Stavileci, Shefi i Operacioneve të Komisionit Evropian, z.Christof Stock dhe shumë mysafirë të tjerë.

Me fermerë prodhues të dredhëzave janë mbajtur 5 trajnime me temat e trajnimeve:

- Brendimi i produkteve
- Të ushqyerit dhe mbrojtja e dredhëzës për të pas një prodhim cilësor
- Përgatitja për pjesëmarrje në Ditën e dredhëzës
- Rëndësia e përzgjedhjes së fidanëve dhe imputeve për dredhëza
- Mbrojtja e dredhëzës nga temperaturat e ulëta



Në këto trajnime kanë marrë pjesë 84 fermerë ose 17 fermerë për trajnim.

Për 20 prodhuesit e dredhëzës është përgatitë brendi, tiketat dhe është bërë furnizimi me 8000 paketime të ndryshme varsishte nga saisa e paketimit. Të gjithë këta fermerë kanë marrë pjesë me prodhimet e tyre në “Ditën e Dredhëzës” e cila është mbajtur me 16.06.2011 në Skenderaj. Dy fermerë kanë arrit të shpërblehen për prodhimtari të dredhëzës.

Pemishtja demonstruese e mollës

Zhvillimi i sektorit të pemëve në regjionin e Mitrovicës në dhjetë vitet e fundit është bërë në sajë të përkrahjes së fermerëve me pilot-projekte të ngritjes së plantacioneve të pemëve (mollës, kumbullës) me sipërfaqe prej 0.5 ha. Pothuajse të gjitha plantacionet e ngritura me pemishte në këtë regjion gjatë kësaj periudhe janë ngritur nga kontributet e çmuara të donatorëve të cilët e kanë përkrahur IADK-në në implementimin e këtyre projekteve. Kushtet e mira klimatiko-tokësore dhe interesimi në rritje i fermerëve për të zhvilluar më tej këtë prodhimtari e kanë shtyrë IADK-në që të investojë në ngritjen e një pemishteje intensive me mollë, e cila është model i demonstrimit të praktikave më të avancuara pomoteknike.



Për këtë qëllim në pranverë është përkrahur një fermer nga fshati Vaganicë i komunës së Mitrovicës në ngritjen e një pemishteje të mollës me sipërfaqe prej një hektari. Përfituesi është furnizuar me 2250 fidanë të mollës dy vjeçare (Golden delicious, Gala, Starking, Pink Lady dhe Greny Smith), Sistemin mbështetës komplet (shtylla, bambu, tel, ankerë dhe shtrëngues teli), Sistem të ujitjes pika-pikë komplet me rezervar të ujitjes, Pompë spërkatëse, pako të pesticideve, pleh mineral, gerëshër për krasitje, lidhëse plastike dhe pajisje për rregullimin e këndit të degëzave.

I tërë procesi i ngritjes dhe përkujdesjes së pemishtes është mbikëqyrur për së afërmi nga stafi i IADK-së me qëllim të realizimit të drejtë dhe në kohë të punëve. Pemishtja ka pas një zhvillim të mbarë dhe vitin e ardhshëm do të filloj prodhimin. Po ashtu gjatë vegjetacionit pemishtja është shfrytëzuar edhe si qëndër për



demonstrimin praktik të teknikave të kultivimit intensiv të mollës për fermerët tjerë të interesuar, të cilët më parë kanë nënshkruar një kontratë për ndjekjen e trajnimeve. Gjatë vitit janë mbajtur 8 sesione të trajnimeve me dy grupe të fermerëve ku kanë marrë pjesë 30 fermere, të cilët njohurit e fituara nga keto trajnime i kanë aplikuar në pemishtete tyre.

Serra demonstruese

Në kuadër të avancimit të prodhimtarisë së perimeve dhe me qëllim të demonstrimit të teknikave më të mira në këtë lëmi, IADK-ja ka ngritur një serrë moderne me sipërfaqe prej 500 m² në fshatin Çabër të komunës së Zubin Potokut. Serra është e pajisuar edhe me sistem të ngrohjes, sistem të ujitjes pikë-pikë, rezervar, foli të zezë plastike, agril foli, plehra minerale komplekse granulë dhe kristalorë, pompë spërkatëse, pako të pesticideve, spango për mbështetje dhe lidhje të bimëve si rrjetë për hijezim për mbrojtje nga temperaturat e larta.

E gjithë puna në serrë është bërë në bazë të rekomandimeve të stafit profesional të IADK-së, ndërsa për të percjellur këshillat praktike gjatë vegjetacionit të perimeve, kemi formuar dy grupe të fermerëve me të cilët janë organizuar trajnime në baza mujore. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 8 sesione të trajnimeve me dy grupe të fermerëve ku kanë marrë pjesë 272 pjesëmarrës.

Mbjellja në serrë ka përfunduar me 20 Maj ku janë mbjellë 1500 fidanë të domates apo 3 bimë për m². Vjeljet e para të frutave kanë filluar me 16 korrik ndërsa ka përfunduar me 20 shtator.

Prodhimtaria e tërësishme e domateve gjatë tërë vegjetacionit ka qenë 10300 kg, prej tyre 10025 kg janë shitur dhe pjesa tjetër është përdorë për nevojat familjare. Çmimi i shitjes ka lëvizur nga 0.25-0.50 €/kg, mesatarja e çmimit ka qenë 0.35 €, që do të thotë se fermeri ka realizuar të hyra prej 3508.75 €.

Domatet janë shitur kryesisht në tregun e gjelbër lokal të Mitrovicës dhe në qendra tregtare.

Duhet cekur se këtë vitë prodhimtaria e perimeve në përgjithësi ka qenë e lartë mirëpo çmimi i shitjes nuk ka qenë i favorshëm për fermerët, por përfituesi i ynë në sajë të cilësisë së lartë të domateve, dhe shitjes direkte të konsumatorët, ka arritur të realizojë çmim më të mirë të shitjes se fermerët tjerë.

Në gjysmën e dytë të tetorit, pasi kultura kryesore/domatja ka përfunduar vegjetacionin, fermeri ka larguar bimët e vjetra dhe ka përgatitur tokën për



mbjelljen e perimeve vjeshtore përkatësisht ka bërë mbjelljen e spinaqit. Në serrë kanë punuar rregullisht dy punëtorë të familjes përfituese ndërsa kohë pas kohe varësisht nga dinamika e punëve janë kyçur edhe dy punëtor tjerë.

Kjo serrë do të shfrytëzohet edhe për prodhimin e fidanëve të perimeve dhe të luleve me teknika më të avancuara, e po ashtu do të shfrytëzohet edhe për demonstrimin praktik të kësaj prodhimtarie edhe për fermerët tjerë.

6 serrat 200 m² me inpute përcjellëse

Edhe këtë vit IADK-ja duke e parë interesimin e madh të fermerëve për ngritjen e serrave, koston e lartë të ngritjes së serrave modernë dhe gjendjen ekonomike jo të favorshme të fermerëve për të investuar në këtë drejtim, në pranverë ka përkrahur 5 përfitues/prodhues të perimeve me nga një pako gjithëpërfshirëse e cila ka përmbytur: **ngritjen e serrave 200m², inputet bujqësore dhe edukim profesional**. Në vjeshtë për shkak të kursimeve që kanë ndodhur, është përkrahur edhe një fermer shtesë me një serrë të tillë, i cili ka përfituar serrën së bashku me pakon e inputeve përcjellëse. Dinamika e realizimit të projektit është bërë sipas planit të paraparë. Pas kompletimit të serrës dhe pakos së inputeve është vazhduar me mbjelljen e fidanëve e cila është bërë në fund të muajit Prill, kurse vjelja e frutave të perimeve ka filluar te trangulli në fillim të Qershorit, speci në fund të Qershorit dhe domatës në fillim të Korrikut. Në fund të Tetorit dhe fillimi i Nëntorit është bërë mbjellja e spinaqit dhe sallatës. Struktura e kulturave të mbjella për 5 përfituesit në sipërfaqen e përgjithshme të serrave prej 1000 m² ka qenë: 70 m² me spec, 760 m² me domate dhe 170 m² me trangull. Nga pesë përfitues dy prej tyre kanë kultivuar spec, domate dhe trangull, dy tjerë kanë kultivuar trangull dhe domate, kurse një ka kultivuar vetëm domate. Qmimi mesatar i shtjes për spec ka qenë 0.6 € për domaten 0.4 € dhe për trangullin 0.2 €. Të ardhurat mesatare për një përfitues nga kultivimi i specit, domates dhe trangullit kanë qenë 1247 €.

Ndërsa në sezonën vjeshtore fermerët në serra kanë bërë mbjellje të kombinuara me spinaq dhe sallata. Po ashtu të hyrat nga shitjet e spinaqit dhe sallatës pritet të jenë afër 400 € për përfitues, dhe të ardhurat mesatare të përgjithshme për një përfitues të serrës 200m² do të janë rreth 1647 €. Këtë vit përkundër prodhimit të lartë dhe cilësisë shumë të mirë të perimeve, çmimi i shitjes së domateve ka qenë tejet i ulët, kurse te trangulli çmimi shumë i ulët dhe vështirësi në shitje/pasoja nga deklaratimet e gabuara të helmimit të njerzve në Gjermani nga konsumimi i trangujve.



Pamje e serrës dhe vizitës nga donatori



Frutifikimi i domateve në serrë

Kultivimi i trangullit kornishon

Qëllimi i këtij projekti ka qenë nxitja e fermerëve për zgjerimin e seipërfaqeve me kultivimin shpalir të kornishonit, duke arritur prodhimtari të lartë dhe cilësi të mirë të prodhimit, zvogëlim të importit dhe krijimin e të hyrave nga kjo prodhimtari. Në kuadër të këtij aktiviteti kanë përfituar 14 fermerë nga 6 komuna: Vushtri (3), Mitrovicë(1), Skenderaj(3), Drenas(2), Podujevë (2), Çabër (3) komuna e Zubin Potokut.

Çdo përfituesi i është siguruar nga një pako komplete e imputeve për mbjelljen e sipërfaqes prej 1000m² me Kornishon: fara hibride të kornishonit, rezervuar me kapacitet 1000 litra, sistemin e ujitjes pikë-pikë, folinë e zezë plastike, substrati për mbjelljen e farërave, pleh mineral NPK, pleh kristalorë, një pako të pesticideve, një pompë spërkaste, tel të galvanizuar dhe rrjetë plastike për lidhjen/mbështetjen e bimëve.

Për përfituesit është përgatitur edhe nga një udhëzues praktik për mënyrën e kultivimit të trangullit Kornishon, dhe janë mbajtur trajnime dhe këshilla praktike gjatë vegjetacionit.

Mbjellja e farave është kryer nga 7 deri më 23 korrik, ndërsa vjelja ka filluar 23 gushtit dhe ka mbaruar me 15 tetor. Rendimenti mesatarë ka arritur 3500 kg/1000m² ndërsa ai më i lartë mbi 5700 kg/1000m². Çmimi mesatar i shitjes ka qenë 0.48 €/kg. Të hyrat mesatare për një fermer kanë qenë 1664 €.

Muaji	Vjelja sipas muajve	Çmimi mes. i shitjes €/kg	Vlera e shitjes/ €/	Konsumi familjar /kg
	Total i shitjeve/kg			
Gusht	4456	0.43	1908	247
Shtator	30847	0.48	14802	580
Tetor	13240	0.50	6595	350
Total	48543	0.48	23305	1177
Mes. për përfitues	3467	0.48	1664	80



Pregatitja e tokës për mbjellje



Vjelja e kornishonve

Ngritja e Pemishteve intensive me kumbull nga 0.5 ha me sistem modern

Për këtë komponentë kanë shpreh interesim 21 fermer prej të cilve janë përzgjedhë 7 nga 4 komuna të ndryshme: Vushtrri (2), Skenderaj (2) dhe Drenas (2) dhe Podujevë (1). Secili përfitues me kohë është furnizuar me nga një pako për ngritjen e 0.5ha të pemishtes intensive kumbull: fidanë dy vjeçare të kumbullës të certifikuara 430 copë (*Stenlej, E hershmja e Çaqakut dhe Frytdhënsja e Çaqakut*), 2 palë gershër për krasitje tip “kuker”, pompë spërkatëse CP3 20 L, pleh mineral 600 kg NPK 15:15:15, pako të pesticideve, sistemin e ujitjes pikë – pikë, Mbjellja është bërë me kohë optimale, me material fidanor cilësor të prodhuar në Kosovë me distanca të mbjelljes 4 x 3 m. Me përfituesit e pemëve janë mbajtur 5 sesione të trajnimeve me tema të ndryshme të cilat janë të lidhura me ngritjen dhe mirëmbajtjen e pemishteve. Të gjithë përfituesit janë monitoruar dhe këshilluar direkt në fermë gjatë tërë procesit të ngritjes së pemishteve. Gjithashtu përfituesit



janë furnizuar edhe me broshura praktike për pemë dhe skica detale për ngritjen e pemishteve të përgatitura nga stafi i IADK-së.

5 Pika grumbulluese të frutave pyjor

Realizimit i këtij aktiviteti të ri fillimisht i ka paraprirë hulumtimi i rrjetit të grumbullimit të frutave pyjor dhe bimëve mjekuese në zonat rurale të regjionit të Mitrovicës. Përfituesit e këtij projekti janë nga fshatrat e 4 komunave Vushtrri (1) Skenderaj (2), Mitrovicë (1) dhe Leposaviq (1). Si kritere bazë për përzgjedhjen e përfituesve ka qenë eksperiencia në grumbullimin dhe shitjen e këtyre prodhimeve, infrastruktura e objektit, sigurimi i tregut etj.


Secili përfitues ka perfituar tharëse elektrike me kapacitet 2 m³, një makinë për prerjen e këpurdhave, një makinë për prerjen e frutave dhe një komorë ftohëse 20 m³. Shfrytëzimi i këtyre pajisjeve ka filluar në fund të muajit Maj menjëherë pas pranimit nga përfituesit

Nga kursimet e bëra në fund të vitit është arritur që të mbështetet edhe një kandidat rezervë nga Komuna e Skenderajt me 3 pajisje: një tharëse elektrike me kapacitet 2 m³ një makinë për prerjen e frutave dhe një komorë ftohëse 20 m³

Me qëllim të aplikimit të disa njohurive bazike lidhur me grumbullimin e frutave pyjor dhe bimëve mjekuese janë organizuar dy cikle të trajnimeve: Aspekte teknike të grumbullimit dhe mbajtja e shenimeve. Në ciklin e parë janë zhvilluar 12 sesione të trajnimeve në 6

lokalitete ku kanë marrë pjesë 150 mbledhës të frutave pyjor, ndërsa cikli i dytë është dedikuar më tepër Pikave Grumbulluese të frytave malore dhe bimëve mjekuese, dhe janë zhvilluar dy sesione të trajnimeve ku kanë marrë pjesë 6 përfaqësues të PGFP (4 përfitues të këtij viti dhe dy përfitues nga viti i kaluar).

Gjatë këtij viti janë grumbulluar 2 lloje të bimëve mjekuese (*Aguliqja*, *shtogu*) dhe 2 lloje të këpurdhave (*pankushja* dhe *dhelprakja*) dhe 4 lloje të frutave pyjor (*boronica*, *molla e egër*, *kaqa*, *dëllenja e zezë*). Është arritur që në 4 PGFP të



grumbullohen 147215 kg të këtyre prodhimeve me një çmim mesatar 1.4 € ose gjithsej 207500 €. Nga kjo vlerë kanë përfituar 400 familje nga 50 fshatra të ndryshme të regjionit të Mitrovicës mesatarisht 520 € për familje. Një pjesë të prodhimeve të grumbulluara nga fshatarët janë terur me pajiset që i kanë marrë nga IADK dhe një pjesë janë shitur të freskëta në Qendra grumbulluese më të mëdha. Pastaj nga këto qendra janë eksportuar në vende të ndryshme jashtë Kosovës. Sasia e përgjithshme e prodhimeve të grumbulluara ka qenë 147215 kg, prej tyre 42450 kg është tharë dhe i është rritur vlera për 52%. Katër pikat grumbulluese nga shitjet e prodhimeve të frskëta dhe të terura kanë krijuar fitime prej 46700 € ku disa nga pikat kanë qenë më të suksesshme ndersa disa kanë pasë rezultate më të ulëta.

Organizim i fermerëve

Tani USHFRM eshte funksional ka sistem demokratik te funksionimit ka ceftifikaten e regjistrimit ka selinë dhe zyrën vet në Mitrovicë të pajisur me të gjithë inventarin e nevojshëm. Kjo zyrë përveq që sherben për plotësimin e nevojave të Unionit sherben edhe si vend për mbajtjen e trajnimeve për anëtarët e shoqatave që veprojnë në kuadër të këtij Unioni.

Pas themelimit dhe legalizimit të plotë të “Unionit të Shoqatave të Fermerëve në Regjionin e Mitrovicës – USHFRM i cili numëron 17 organizata të fermerëve (15 shoqata dhe dy kooperativa). Gjatë vitit IADK e ka mbështetë Union në sigurimin e një zyre dhe paisjen e sajë me inventarë. Gjithashtu Unioni ka qenë i kyqur në të gjitha aktivitetet e fermerëve në regjionin e Mitrovicës të cilat kanë ndodhur gjatë këtij viti.

Po ashtu me qëllim të ngritje së kapaciteteve të USHFRM-së është mbajtur edhe një cikël prej 5 sesioneve të trajnimeve ku janë trajtuar tema si:

- Kriteret dhe format e aplikimit në grantet dhe subvencionet e MBPZHR në sektorët e perimeve, pemëve dhe blegtorisë vitin 2011dhe grandet e BE në Kosovë”
- Mbajtja e shenimeve në fermë, përgatitja e biznesplaneve dhe krijimi i bizneseve

Vlen të theksohet se nga grantet e MBPZHR pas këtyre trajnimeve kanë përfituar 16 fermerë dhe nga grantet e USAID/NOA-s 3 fermer të sistemuar nëpër shoqata brenda Unionit të Fermerëve.

Panaire

Në këtë vitë IADK ka qenë bashëorganizator i “Ditës së Dredhës 2011” dhe bartës kryesor i organizimit të “Panairit Regjional për Bujqësi Mitrovica 2011”.

“Dita e Dredhëzës 2011”

Që nga viti 2009 ka filluar mbajtja e “Ditës së dredhëzës” në komunën e Skenderajt e cila tani ka fituar një karakter nacional dhe është organizuar edhe këtë vit me 16 Qershor 2011. Ky eveniment ishte bashkëorganizim i Komunës së Skenderajt, IADK-së dhe MBPZHR-së. Si mbështetës të këtij organizimi kanë qenë edhe Agjencia për Zhvillim Regjional Veri. Në këtë ditë kanë marrë pjesë me ekspozimet e tyre rreth 40 prodhues dhe përpunues të dredhëzës nga gjithë Kosova ku dhe kanë zgjuar interesimin e një numri të madh të vizitorëve. Në këtë ditë kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve publike në mesin e tyre edhe Ministri i Bujqësisë, z.Blerand Stavileci.

Në këtë promovim nga organizatorët u ndanë 5 shpërblime për prodhuesit më të suskeshëm të dredhëzës:

1. Prodhuesi më i mirë i fidanëve të dredhëzës- Xhavit Mulaj, Llukë e Epërme, Deçan
2. Prodhuesi i hershëm- Armend Malazogu, Kravaricë Gjilan
3. Prodhuesi i sukseshëm në fushë në fushë të hapur- Jonuz Sylja, Ternavë, Skenderaj
4. Përpunuesi më i mirë – kompania “Moea – Frutomania”
5. Ekspozuesi më i mire i frutave Sami Doroci, Broboniq, Mitrovicë

Këto organizime po ndikojnë në sensibilizimin e opinionit për prodhimtarinë e kësaj kulture, rritjen e motivimit të fermerëve dhe njohjen e konsumatorit me prodhimet vendore.

Panairi i Regjional për bujqësi Mitrovica 2011

Më 16 dhe 17 Shtator 2011 është organizuar “Panairi Regjional për bujqësi – Mitrovica 2011” në qytetin e Mitrovicës. Si panair regjional është organizuar për herë të dytë ndersa për herë të parë është përfshirë ekspozimi i kafshëve të gjalla. Ky panair është organizuar nga IADK në mbështetje të USHFRM, Komunës së Mitrovicë, Komunës së Skenderajt, Komunës së Vushtrrisë, OEK, AKB. Panairi ka pasur karakter promovues, garues dhe shitës. Në ceremoninë e hapjes së panairit kanë marrë pjesë Ministri i BPZHR, dhe përfaqësues të autoriteteve komunale. Në këtë promovim prodhimet e tyre për dy ditë radhazi i kanë ekspozuar mbi 130 prodhues të ndryshëm: prodhues të pemëve (14), perimeve (12), bletarë (24), blegtorë (30) përpunues tradicional (50). Ditën e parë janë ekspozuar kafshët si gjedhet, delet, dhitë si dhe prodhimet



ushqimore ndërsa ditën e dytë është bere ekspozimi i prodhimeve ushqimore. Pasi ky panair ka pasë edhe karakter garues janë shpërblyer 19 fermer prej tyre 15 në sektorin e blegtorisë, 1 prodhues i pemëve 1 prodhues i perimeve një bletarë dhe 1 përpunues tradicional. Ky panair ka zgjuar një kureshtje të madhe dhe ka pas një numër shumë të madh të vizitorëve jo vetëm nga qytetet e regjionit por nga tërë Kosova të cilët kanë shfrytëzuar rastin të blejnë prodhimet vendore. Gjithashtu panairi është përciellë për së afërmi edhe nga mediat kombëtare dhe lokale.

Publikimet

Broshura **“Prodhimtaria intensive e mollës”** – Kjo broshure është përgatitur në 60 faqe ku janë përfshirë temat praktike që janë mbajt me fermerë në pëmishten demonstruese. Kjo broshure ka përmbajtje mjaft ilustrative me foto dhe skica praktike me qëllim që të jetë sa më e kuptueshme dhe e përdorshme për fermerë.

Doracak botanik i bimëve mjekuese dhe frutave malor – Ky doracak përmbanë udhëzime praktike për mbledhjen e 66 lloje të bimëve mjekuese aromatike dhe frutave malorë. Paraqitja e këtij doracaku është bërë në mënyrë mjaft ilustrative me foto dhe është shumë i përdorshëm për mbledhësit e bimëve.

Tregim i Ahmet Ukës

Ahmeti jeton në fshatin Çabër Komuna e Zubin Potokut bashkë me familjen 5 anëtarëshe. Ka një sipërfaqe të tokës së punueshme prej 1 ha, në të cilën më parë krpoisht ka kultivuar grurë, misër, fasule dhe patate vetëm për nevojat familjare, ndërsa tani prodhimtari primar ka kultivimin e perimeve të cilat i ka burim krpoor të të hyrave familjare.

Në vitet e '90-ta kishte jetuar në Gjermani, ku afër 7 vite kishte punuar në një kompani që merrej me prodhimin e fidanëve të luleve dhe të perimeve në serrë, ku kishte fituar një përvojë bukur të mirë. Pas kthimit në fshatin e tij në vitin 2000 të gjitha investimet të cilat i kishte bërë në ndërtimin e shtëpisë pasi i tërë fshati ishte shkatërruar nga lufta.

Duke e parë të pamundshme gjetjen e një vendi të punës ai fillon të merret me kultivimin e perimeve duke ndërtuar një serrë të thjeshtë me konstruksion druri 30 m². Së pari nis me prodhimin e 500 fidanëve të perimeve dhe nga viti në vit shkon duke e rritur këtë prodhimtari. Për shkak të dëmeve të mëdha që i ishin shkaktuar ekoJomisë familjare dhe koston e lartë që kërkohej në ngritje e serrave, ai nuk ishte në gjendje të investoj në ndërtimin e serrave moderne.

Në vitin 2008 kur IADK-ja fillon aktivitetet në përkrahje të fermerëve në këtë fshat, duke parë interesimin, përvojën dhe para së gjithash nevojën që kishte për përkrahje, ai mbështetet me një serrë prej 100 m², e cila i mundësoi lehtësimin e prodhimit të fidanëve, rritjen e prodhimit të fidanëve dhe zvogëlimin e koston e prodhimit. Duke shfrytëzuar mirë edhe këshillat e ofruara nga ekspertët e IADK-

së, ai arrin që të përmirësojë edhe më tej prodhimtarinë e fidanëve duke përdorur teknika më të avancuara dhe fara të hibrideve të reja të perimeve. Në këtë mënyrë kërkesat për fidanë vinin duke u rritur, andaj ai me vetëfinancim arrin që të ndërtojë edhe një serrë tjetër prej 100 m².

IADK-ja duke i parë mundësitë e kufizuara financiare të këtij fermeri për të investuar në avancimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të kësaj veprimtarie, motivin e tij të lartë për punë, gatishmërinë për bashkëpunim edhe me fermerë të tjerë vendosi ta mbështesë edhe një herë. Në pranverë të vitit 2011 përmes një projekti të financuar nga komisioni evropian dhe zbatuar nga IADK e mbështetë në ndërtimin e një serra moderne model 500m² me sistem të ngrohjes dhe pajisje tjera të nevojshme për prodhimtari të suksesshme.

Gjatë vitit në këtë serrë janë prodhuar mbi 10000 kg domate me një vlerë 3500€. Gjatë tërë vitit serra ka shërbyer si një shkollë trajnimit për aftësimin e 34 fermerëve të cilët kanë pasë rastë të njihen me aplikimin e teknikave të reja të kultivimit të perimeve në serra. Tani në sezonin vjeshtor e tërë serra është mbjell me spinaq nga shitja e të cilit priten të hyra afërsisht prej 1000 €.

Në vitin 2012 ky fermer në sajë të mundësive të mira që janë krijuar nga ngritja e kësaj serra e sidomos instalimi i sistemit të ngrohjes planifikon të prodhojë afër 50 mijë fidanë të perimeve dhe luleve.

Të gjithë suksesin e arritur në avancimin dhe zgjerimin e kësaj veprimtarie Ahmeti thotë se e ka arritur vetëm në sajë të përkrahjes së vazhdueshme nga ana e IADK-së, dhe për këtë ai është falënderues dhe shumë mirënjohës ndaj stafit të organizatës dhe donatorëve të saj.

DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Promovimi i aktiviteteve me gra në zona rurale –përpunimet shtëpiake

Gjatë vitit 2011 sektori i përpunimit është fokusuar në tri drejtime

1. Edukim dhe trajnimin e grave (qumësht, pemë dhe perime)
2. Provimin e produkteve vendore
3. Bashkëpunimi me organizata të tjera

Edukimi dhe trajnimi i grave

Në kuadër të aktivitetit të trajnimit të grave janë formuar tri module të trajnimeve si moduli i qumështit, perimeve dhe i pemëve. Në modulën e qumështit janë formuar 4 grupe, në modulën e perimeve 4 grupe dhe në modulën e pemëve 5 grupe.

Trajnimet ne modulën e qumështit

Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë që gratë të trajnohen në përpunimin e qumështit dhe në përmirësimin e kualitetit të prodhimeve të tyre. Ky modul ka përmbytur 30 sesione të trajnimeve ku janë formuar katër grupe nga komunat e Vushtrisë, Mitrovicës, Skenderajt dhe Podujevës dhe janë trajnuar në përpunimin e 13 llojeve të djathërave me gjithsej 68 gra kane ndjekur trajnimet. Në fund të trajnimeve secila kandidate i është nënshtruar testit për verifikimin e njohurive të arritura gjatë trajnimeve, gratë të cilat kane treguar sukses në test janë certifikuar. Me qëllim të fuqizimit të grave, IADK gjatë vitit 2011 ka angazhuar 2 asistente nga pjesëmarrëset e trajnimeve, për mbajtjen e trajnimeve për grupet e grave tjera të regionit të Mitrovicës.



Nga ky numër i grave të certifikuara, 9 prej tyre kanë filluar shitjen e djathërave të ndryshme në vlerë prej 3500 euro. Këto gra kanë bërë shitjen e prodhimeve të tyre nëpër tregje të ndryshme, në tregun e Mitrovicës, restorante të ndryshme, panaiere të ndryshme e në tregje lokale. Më së shumti është bërë shitja e djathit me perime, si një produkt i ri në tregun tonë.

Trajnimet ne modulën e pemëve

Në modulën pemëve janë formuar 4 grupe të grave në komunat e Mitrovicës, Skenderajit, Vushtrisë dhe Drenasit. Trajnimet në modulën e pemëve janë zhvilluar në 30 sesione, ku numri i përgjithshëm i kandidateve të trajnuara ka qenë 82 gra. Pjesëmarrëset në trajnime janë aftësuar për prodhimin e 16 llojeve të xhemëve, reçelrave, lëngjeve etj. Në fund të trajnimeve gratë pjesëmarrëse janë certifikuar për përpunimin e pemëve. Gjatë këtij viti IADK ka angazhuar një asistente e cila ka ndjekur trajnimet në mbajtjen e trajnimeve për grupet tjera të grave në komunën e Vushtrisë. 7 gra të cilat kane kryer trajnimet e këtij moduli kane gjete tregun për shitjen e produkteve ku vetëm për një kohe të shkurtër janë shitur produkte në vlerë prej 2010 euro. Promovimin e produkteve më së shumti e kanë bërë në panaiert e ndryshme të organizuara në Kosovë gjatë këtij viti. Përveç shitjes, në këto panaiere janë krijuar kontakte me konsumatore të ndryshme.



Trajnimet ne modulën e perimeve

Trajnimet në modulën e perimeve janë organizuar në tri grupe në komunat e Drenasit, Vushtrisë dhe Skenderajt. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë që gratë të marrin njohuri për përpunimin e perimeve dhe në fuqizimin e tyre në aspektin ekonomik. Në këto tri grupe kanë marrë pjesë 62 gra të cilat janë trajnuar në aspektin praktik për përpunimin e perimeve. Në fund të trajnimeve, pjesëmarrëset i janë nënshtruar testit mbi njohurit e marra në trajnim. Edhe në kuadër të këtij aktiviteti, IADK gjatë vitit 2011 ka angazhuar një asistente për mbajtjen e trajnimeve me grupet e grave në sektorin e përpunimit të perimeve. Me kërkesë të grupit të grave serbe nga komuna e Vushtrisë, IADK ka organizuar trajnime intensive për këtë grup ku janë trajnuar 12 kandidatë në përpunimin e perimeve.



Nga numri i përgjithshëm i grave, 9 veta nga këto kanë bërë shitjen e produkteve të prodhuara me receta të cilat janë mësuar gjatë trajnimeve. Promovimi i tyre është bërë në panairë të ndryshme ku janë krijuar kontakte me restorante të ndryshme si restoranti Shpeta, Monako në Prishtinë, e familje të ndryshme. Këto gra gjatë kësaj periudhe kanë bërë shitjen në vlerë 2975.5 euro.

Përpunimi shtëpiak i pemëve dhe perimeve

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve përpunuese të pemëve dhe perimeve dhe fuqizimit të grave IADK gjatë vitit 2011 ka ngritur katër pika përpunuese të pemëve dhe perimeve me pajisje për përpunim dhe trajnimin e grave në përpunim të pemëve dhe perimeve. Dy pika përpunuese janë ngritur në Vushtri; një për grupin e grave shqiptare dhe një për grupin e grave serbe, një pikë përpunuese në Skenderaj dhe një në Podujevë. Përfutuese të këtyre pikave kanë qenë gratë të cilat kanë ndjekur trajnimet e IADK-së. Të gjitha pikat përpunuese kanë filluar me përpunimin e pemëve dhe perimeve në prodhime të ndryshme si xhem të kumbullës, kompot kumbulle, ajvar, sallatë të përzier, kornishon, specat të konservuar. Meqenëse ka qenë viti i parë i prodhimit, gratë përfutuese janë ndarë shumë të kënaqura dhe deri me tani kanë arritur të përpunojnë mbi 2000 kg pemë



dhe perime. IADK po ashtu ka bërë promovimin e produkteve vendore, duke organizuar panairin për promovimin e prodhimeve ushqimore dhe po ashtu i ka përkrahur gratë në pjesëmarrjen në panairot e ndryshme të organizuara në Kosovë.

Krijimi i shoqatave të grave

Gjatë vitit 2011 IADK ka përkrahur gratë nga komunat e Vushtrrisë dhe Skenderajt në themelimin e dy shoqatave të grave. Ne komunën e Vushtrrisë është themeluar Shoqata “Konvita”, ku kjo shoqatë është përkrahur edhe me të gjitha pajisjet për zyrë të shoqatës si dhe me trajnime për fuqizimin e grave dhe në menaxhimin e shoqatës. Ndërsa në komunën e Skenderajt është përkrahur themelimi i shoqatës “Natyra”. IADK ka përkrahur këto dy shoqata gjatë gjithë procesit të përgatitjes së dokumenteve për regjistrim dhe ka ndihmuar në përgatitjen e statutit të shoqatës, logon si dhe në zgjedhjen e organeve të shoqatës. Po ashtu ka organizuar trajnime për anëtarët e shoqatës.

Vizita studimore në shkëmbimin e përvojave

Vizita në Maqedoni – me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe avancimit të grave është organizuar vizitë studimore në Maqedoni me grupin e grave. Qëllimi i kësaj vizite tre ditore ka qene që gratë të njihen me praktikën e reja të përpunimit të qumështit, perimeve dhe pemëve. Gjatë kësaj vizite janë vizituar kompani të ndryshme për përpunimin e ushqimit, ku gratë kanë marrë njohuri të reja të cilat



kane filluar ti praktikojnë në Kosovë, ku tash janë duke prodhuar disa produkte me recepturat e marra gjatë kësaj vizite. Ne vizite kane marre pjese 11 gra te regjionit te Mitrovicës. Me ftesë të Federatës së Fermerëve të Maqedonisë një grup i grave nga Kosova kanë marrë pjesë në Ditën ndërkombëtare të gruas rurale”Kërkoje të drejtën tënde për tokë dhe pronësi“ në Maqedoni.

Vizita në Kosovë – gjatë vitit 2011 IADK ka organizuar tri vizita në Kosovë ku kanë marrë pjesë 62 gra nga regjioni i Mitrovicës. Qëllimi këtyre vizitave ka qenë që gratë të njihen me procesin teknologjik të përpunimit të qumështit, pemëve dhe perimeve.

Pjesëmarrja e grave në panaire dhe në ngjarje tjera

Gjatë këtij viti IADK ka përkrahur gratë në pjesëmarrjen në panaire të ndryshme të organizuara në Kosovë me qëllim të promovimit të produkteve të tyre. Panairët apo organizimet në të cilat kanë marrë pjesë grupet e grave janë:

1. Pjesëmarrja në "Dita e Dredhëzës 2011" në Skenderaj e organizuar nga IADK.
2. Pjesëmarrja në Ceremoninë promovuese të projektit "Promovimi I hortikulturës, blegtorisë dhe përpunimit të pemëve në regjionin e Mitrovicës".
3. Panairi Regional "Mitrovica 2011"
4. Panairi i Artizanateve 2011 organizuar nga OJQ "Dera e hapur" Prishtinë
5. Panairi "Produktet bujqësore" e organizuar nga Aleanca Kosovare e Biznesit
6. Panairi "Promovimi i prodhimeve bujqësore" organizuar nga MBPZHR dhe Oda EkoJomike e Kosovës
7. Panairi "AGROKOS & DRINKS 2011"
8. Panairi për nderë të ditës së flamurit
9. Panairi "Ditët e biznesit të vogël"



Gjatë këtyre panaireve dhe promovimeve kanë marrë pjesë mbi 102 gra të cilat IADK i ka përkrahur. Pas pjesëmarrjes së grave në këto promovime, grate të cilat merren me përpunim kanë gjetur tregun edhe jashtë regjionit të Mitrovicës ku tash bëjnë furnizimin e restoranteve dhe marketeve të ndryshme.

Tryeza e rrumbullakët

Gjatë këtij viti IADK ka organizuar tryezë të rrumbullakët me temën "Zhvillimi, mundësitë dhe perspektiva e sektorit të përpunimit shtëpiak" ku kanë marrë pjesë 24 pjesëmarrës, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Rrjetit të Grave të Kosovës, përfaqësues të GIZ, organizatave të ndryshme, tregtarë etj. Në

këtë tryeze janë diskutuar shumë tema që lidhen me sektorin e përpunimit shtëpiak dhe në fund janë dhënë rekomandimet nga ana e pjesëmarrësve:

- Të punohet në zgjidhjen e problemeve të kuantitetit dhe kualitetit
- Të bëhet koordinimi i grupeve të grave nga regjione të ndryshme të Kosovës.
- Të bëhet standardizimi i produkteve shtëpiake
- Jetëgjatësia e këtyre produkteve në treg
- Mbajtja e më shumë tryezave të këtilla



Publikime

Gjatë vitit 2011 IADK ka përgatitur dhe publikuar broshurën “Përpunimi shtëpiak i pemëve” në tri gjuhë: shqip, anglisht dhe serbisht.

Certifikimi i grave te trajnuara

Me 19 Dhjetor. 2011 IADK organizoi ceremoninë e certifikimit të grupeve të grave me ç’rast 126 gra morën certifikatat për kompletimin e trajnimeve në përpunimin e qumështit, pemëve dhe perimeve. Në këtë ceremoni morën pjese 152 pjesëmarrës, kandidatet e 8 grupeve te trajnuara, TOT, Këshilltarja e Ministrit te Bujqësisë znj. Nystrete Doda- Gashi, zyrtarja për çështje gjinore pranë Ministrisë se Bujqësisë, zyrtarë të komunave nga Vushtrria, Mitrovica dhe Podujeva, shoqata të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, përfaqësues të ICO për Mitrovicë etj.



Të arriturat e Departmentit të Përpunimit:

- Është arritur të aftësohen dhe certifikohen 212 gra ne përgatitjen e 13 llojeve djathërash, 16 llojeve të përpunimeve shtëpiake të pemëve, 62 gra për përgatitjen e 18 llojeve të konservimeve te perimeve
- Promovimi nëpërmes panairove ka treguar rezultat në gjetjen e tregut për 26 gra prodhuese të orientuara për treg
- Përveç grave të cilat kanë kryer trajnime në tri module, edhe 26 gra tjera të cilat janë certifikuar më herët janë përkrahur për pjesëmarrje në panaiire të ndryshme ku 14 gra kanë gjetë tregun dhe kanë bërë shitje në vlerë prej 21,264.00 euro.

- Organizimi i tryezës së rrumbullakët ka rezultuar me identifikimin e shumë problemeve si dhe mundësitë e zgjedhjeve të tyre
- Përfutjesja e cila është trajnuar dhe përkrahur nga IADK Selvete Fetahu është shpallur fermere e vitit 2011
- Gjatë këtij viti departamenti i përpunimit i IADK-së është bërë anëtare e RrGGK. Gjatë muajit Shtator IADK ka prezantuar aktivitetet e saja para anëtareve të RrGGK ku pas këtij prezantimi ka rezultuar me takime dhe bashkëpunime me shumë organizata anëtare të rrjetit si dhe pjesëmarrjen e anëtares së bordit në tryezën e rrumbullakët dhe në Ceremoninë e certifikimit të grupeve të grave.
- IADK po ashtu ka thelluar bashkëpunimin edhe me shoqata tjera si Shoqatën "Indira" nga komuna e Klinës dhe Shoqatën "Qendra për ardhmëri të sigurt" nga komuna e Pejës, me të cilat bën shkëmbimin e përvojave dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta.

Tregim nga Lirie Haziri

Liria jeton në fshatin Studime, komuna e Vushtrrisë. Ajo është 37 vjeçare nënë e 2 fëmijëve. Familja e saj ka traditë në prodhimtarinë bujqësore ku posedon me 3 ha toke. Liria ka traditë në përpunimin e perimeve-turshi sipas recepturave të mësuar nga nëna e saj, ku ka bërë përpunimin vetëm për nevojat e familjes së saj por asnjëherë për treg. Në vitin 2010 IADK ka organizuar dhe mbajtur trajnime në fshatin Studime ku kanë marrë pjesë 12 gra nga ky fshat, dhe pjesë e këtij grupi ka qenë Liria. Pas përfundimit me sukses të trajnimeve Liria është përkrahur nga shoqata e IADK-së me mjete për përpunimin e xhemëve të ndryshëm, ajvarit etj. Pas futjes në funksion të këtyre mjeteve Liria ka prodhuar 180 kg xhem të kumbullës pastaj 200 kg ajvar, sallatë të përzier 60 kg, kompot të kumbullës 35 kg, kornishone turshi 40 kg dhe 30 kg turshi. Me përkrahjen e IADK-së Liria ka marrë pjesë në shumë panaire të organizuara në Kosovë ku ka bërë shitjen e këtyre prodhimeve, ka krijuar kontakte të ndryshme si dhe është njoftuar me kërkesat e tregut ku do të shërbejë për planifikimin e prodhimit dhe produkteve të kërkuara nga tregu. Gjatë kësaj kohe ka bërë shitje në vlerë prej 1100 euro. Nëse merret parasysh që Liria para trajnimeve nuk ka shit prodhime ndërsa për tre muaj prej Shtatorit deri në Dhjetor ka bërë shitje në vlerë të mësipërme 1100 euro atëherë ky është një sukses shumë i madh për të si dhe një motivim për rritjen e kapacitetit të prodhimit në mënyrë që në vitet në vijim ajo të krijojë të ardhura më të mëdha me synimin që në një të ardhme të afërt të jetë pronare e një mini fabrike.



Trajnime për menaxhimin dhe planifikimin e fermave

Duke parë mungesën e përvojës së menaxhimit dhe planifikimit të fermave tek fermerët, IADK gjatë këtij viti ka organizuar trajnime dhe këshillime në lëminë e biznesit dhe planifikimit të fermës. Në keto trajnime janë përfshirë fermerët e sektorit të përpunimit (grave), sektorit të pemeve, sektorit të perimeve dhe sektorit të blegtorisë. Në kuadër të këtyre sektoreve janë formuar 9 grupe të fermerëve, ku secili grup ka pasur nga 15 pjesmarrës.

- 2 grupe të (grave) Përpunim – Klinë e Epërme-Skenderaj dhe Brobaniq-Mitrovicë;
- 2 grupe të Pemëve – Mitrovicë dhe Vushtrri ;
- 2 grupe të Perimeve – Mitrovicë dhe Vushtrri;
- 3 Grupe të Blegtorisë – Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Mbajtja e këtyre trajnimeve në lëminë e biznesit ka ardhur pasi që është vërejtur nevoja që përkrah trajnimeve profesionale në lëmit e tyre, të mbahen edhe trajnime biznesi që do t’ju ndihmojnë fermerëve të organizojnë më mirë veprimtaritë e tyre dhe të orientohen nga tregu.

Gjatë këtij viti janë mbajtur 5 trajnime për secilin grup me temat: *Si të fillojmë biznes të ri; SËOT Analiza; Biznes Plani; Brendimi (markimi) i produkteve dhe Marketingu*. Numri i fermerëve që kanë marrë pjesë në këto trajnime është mbi 135. Pas trajnimit fermerët janë aftësuar në llogaritjen e kostos së prodhimit, analizimin e situatave të tregjeve, planifikimin e bizneseve të tyre, marketingun dhe promovimin e produkteve, si dhe menaxhimin në aspektin financiar të fermave apo bizneseve të tyre. Gjatë këtij viti janë përgatitur 21 biznes plane për fermerët, ku me këto biznes plane fermerët kanë aplikuar te donatorë të ndryshëm dhe në MBPZHR, ku 8 fermerë kanë marrë grante nga MBZHR dhe 4 fermerë nga donatorë tjerë. Po ashtu, IADK ka ndimuar fermerët në regjistrimin e bizneseve të tyre ku gjatë këtij viti janë regjistruar 5 ferma.

“Mentorimi Teknik për Vetë – punësim” (“Zgjerimi i Punësimit të Rinjve”)

Gjatë vitit 2011 IADK së bashku me Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë ka implementuar projektin “Zgjerimi i Punësimit të Rinjve” i cili ka qenë i ndarë në dy faza dhe është financuar nga Agjencioni Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



Objektiv kryesor i fazës së parë të projektit “Zgjerimi i Punësimit të Rinjve” ka qenë përgatitja e mentorëve nëpërmjet arsimimit dhe formimit profesional për të

lehtësuar kalimin e tyre nga studimet në vetë-punësim. Gjatë kësaj faze është krijuar baza e mentorëve, ku janë trajnuar 15 mentorë për të udhëzuar dhe këshilluar studentët për punë të pavarur dhe për hapjen e bizneseve të reja në të ardhmen. Pas trajnimit të grupit të mentorëve është bërë përzgjedhja e 10 mentorëve ku janë trajnuar në trajnime shtese për “Trajner të Trajnerëve”.

Faza e dyte e projektit ka qenë kryesisht e fokusuar në promovimin dhe qendrueshmerinë e mentorëve të cilët janë



trajnuar në fazën e parë të projektit. Gjatë kësaj faze mentorët kanë punuar të pavarur me studentë nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe fermerë apo kompani të cilat merren në sektorin e bujqësisë. Secili mentor ka punuar me tre fermerë apo kompani dhe me tre studente të cilët kanë synim në hapjen e bizneseve të tyre. Objektivi kryesor ka qenë që fermerët dhe studentët të trajnohen në menaxhimin e fermave, në planifikimin e bizneseve dhe në përgatitjen e biznes planeve për bizneset e tyre.

Nën mbikëqyrjen e IADK-së, mentorët kanë punuar me studentët dhe fermerët në përgatitjen dhe kompletimin e biznes planeve. Çdo mentor gjatë kësaj faze ka bërë trajnimin e 3 studenteve dhe 3 fermerëve në menaxhimin e bizneseve dhe planifikim, ku gjatë kësaj faze janë përgatitur 30 biznes plane për fermerë apo kompani dhe 30 biznes plane për studentet nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

AKTIVITETE ME PARTNERË PROFESIONAL INTERNACIONAL

Ekspertët Seniorë të PUM nga Holanda

Në sektorin e blegtorisë gjatë vitit 2011 është realizuar një vizitë nga një ekspert nga organizata PUM. Gjatë kësaj vizite janë vizituar fermerë dhe veterinarë të regjionit të Mitrovicës. Qëllimi kryesor i këtyre vizitave ka qenë dhënia e këshillave dhe trajnimi i fermerëve në parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve, pastrimin dhe mjekimin e thundrave të kafshëve, inseminimin artificial.

Gjatë kësaj vizite është mbajtur ligjëratë me studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë së Universitetit të Prishtinës mbi temën “Sëmundjet e Brendshme të Ripërtypësve” ku kanë marrë pjesë 15 studentë dhe asistentë nga fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë. Po ashtu janë trajnuar 4 veterinerë në aspektin praktik të trajtimit dhe parandalimit të sëmundjeve të kafshëve dhe 28 fermerë në menaxhimin e fermave qumeshore.

Në sektorin e hortikulturës janë realizuar dy misione dhjetë ditore të konsulentëve të kësaj organizate.

Misioni i parë - është realizuar në periudhën 01-10 Gusht 2011 me agjendë “Prodhimtaria e perimeve në serra”

Misioni i dytë – është realizuar 19-28.09.2011 me agjendë “Kultivimi i mollës – Periudhe e para, gjatë dhe pas vjeljes dhe Sistemet e kurorave”.

Gjatë këtyre misioneve janë zhvilluar vizita të fermerëve dhe institucioneve (komunat dhe MBPZHR), janë mbajtur trajnime ku kanë marrë pjesë fermerëve, agronomë dhe studentë.

Në sektorin e Përpunimit, gjate vitit 2011 kane qëndruar 2 ekspertë nga PUM, një në përpunimin e qumështit dhe eksperti i përpunimit te pemëve dhe perimeve.


Vizitat me fermerë dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme

Nr.	Vendi	Kohëzgjatja	Nr.i pjesm.	Agjenda
1	Kosovë (Shtimje, Gjilan, Ferizaj)	1 ditore	15	Prodhimtaria e perimeve në serra
2	Kosovë (Podujevë)	1 ditore	13	Prodhimtaria e prodhimit të kornishon
3	Kosovë(Gjilan,Viti)	1 ditore	12	Prodhimtaria e pemëve dhe fidanëve
4	Shqipëri (Shkodër, Lushnje,Beratë, Vorë)	3 ditore	10	Prodhimtaria e perimeve
5	Shqipëri (Korçë, Kavajë)	4 ditore	12	Prodhimtaria e pemëve
6	Maqedoni	1 ditore	11	Përpunimi i ushqimit
7	Kosovë , Podujevë	1 ditore	10	Përpunimi i perimeve
8	Kosovë, Brojë dhe Podujevë	1 ditore	25	Përpunimi i jogurtit/ perimeve
9	Kosovë, Krushë	1 ditore	29	Përpunim i turshive
10	Vizitë e fermerëve nga Maqedonia në Kosovë	2 ditore	5	Higjiena e qumështit
11	Vizitë në Maqedoni	3 ditore	10	Sektori i deleve, dhive
12	Konferencë në Bruksel, Drejtori Ekzekutiv	3 Ditore	1	Roli i shoqërisë civile në bujqësinë organike
13	Konferencë në Shkup	2 Ditore	2	Kooperativat bujqësore
14	Konferencë në	1 ditore	1	Zhvillimi rural dhe

	Bruksel, Menaxheri i Zyrës			punësimi në Ballkanin Përqendror, EESC
15	Konferencë në Tiranë, Drejtori Ekzekutiv	2 ditore	1	BAAN
16	Vizitë në Bari, Itali	3 ditore	3	Instituto Agronomico Mediterraneo Bari
17	Vizite në France	10 ditore	4	Proshimtaria e qumështit
18	Berlin, Gjermani, Drejtori Ekzekutiv	2 ditore	1	Zbulimi, parandalimi i mashtrimeve në projekte ndërkombëtare

Të hyrat e IADK-së nga fondet e Donatorëve dhe Partnerëve gjatë vitit 2011

	Emri i donatorit/partnerit	Emri i Projektit	Shuma	%
1	ZNKE (Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë)	Promovimi i Bujqësisë, Hortikulturës, Blegtorisë dhe Përpunimit të Frutave në Regjionin e Mitrovicës	214,586	33%
2	Komunat	Promovimi i Bujqësisë, Hortikulturës, Blegtorisë dhe Përpunimit të Frutave në Regjionin e Mitrovicës	20,000	3%
3	Fin Church Aid	Mbështetje sektorit të Hortikulturës dhe Blegtorisë	160,000	25%
4	Evangelischer Entwicklungsdienst-EED	Fuqizimi i kapaciteteve institucionale të fermerëve	94,478	15%
5	Projekti i CoS	Edukimi i grave në përpunim shtëpiak dhe grumbullim bimësh malore	67,342	11%
6	Projekti i SDC	Ngritja e Punësimit të Rinjëve	29,672	5%
7	Projekti i AFDI	Shkëmbim përvojash	3,000	0.5%
8	Kontributi lokal	Projekti 1,3,5	51,716	8%
	Totali		640,794	100%



Stafi i IADK-së për vitin 2011

Emri dhe Mbiemri	Departamenti	Pozita
Zenel Bunjaku	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
Shemsedin Aliu	Menaxhment	Menaxher i Zyrës
Esma Azemi	Financa	Zyrtare e lartë për Financa dhe Admin.
Ariana Selmani	Financa	Zyrtare për Financa dhe Administratë
Elheme Shala	Administratë	Ndihmëse Teknike
Petrit Koci	IT / Administratë	Ndihmës i IT-së
Vahid Avdiu	Pemëtari-hortikulturë	Udhëheqës i departamentit të hortikulturës
Sylejman Bunjaku	Perimtari	Inxhinier i Bujqësisë
Gursel Arifi	Blegtori	Udhëheqës i departamentit të blegtorisë
Xhavit Shala	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
Skender Fejzullahu	Pemëtari-hortikulturë	Asistent i Hortikulturës
Hanumshahe Zeneli	Përpunim	Zyrtare Projekti
Hafize Veseli	Përpunim	Zyrtare Projekti

Magbule Hyseni	Përpunim	Udhëheqëse e sektorit të përpunimit
Arbenita Osmani	Projekti i SDC-së	Koordinatorë projekti
Esma Azemi	Financa/Administratë	Zyrtare e lartë për financa
Burim Morina	Administratë	Trajner biznesi dhe këshilltar financash
Florentina Hasani	Financa dhe Administratë	Praktikante
Bekri Bajrami	Blegtori	Praktikant
Sherif Mehmeti	Hortikulturë-pemëtari	Praktikant
Nedime Azemi	Financa	Praktikante
Liridon Mustafa	Hortikulturë-pemëtari	Praktikant
Liridona Tahiraj	Trajnime	Trajnere
Shehrije Ahmeti	Trajnime	Trajnere
Nehat Velu	Trajnime	Trajner
Fehmi Mehmeti	Trajnime	Trajner
Ardita Hoxha Jahja	Trajnime	Trajnere
Selvete Fetahu	Trajnime	Trajnere
Hysen Bytyçi	Trajnime	Trajner
Zenel Elshani	Trajnime	Trajner
Donika Habibaj Prapashtica	Trajnime	Trajnere
Nijazi Bytyçi	Konsulencë	Konsultant
Albiona Beqiri	Trajnime	Trajnere
Nedime Gerxhaliu	Trajnime	Trajnere
Merita Selimi	Trajnime	Trajnere
Mitar Zdravic	Trajnime	Trajner
Dragi Mihajlov	Trajnime	Trajner
Habib Mehulli	Përkthime	Përkthyes
Tefik Maloku	Përkthime	Përkthyes
Vildane Mulaku	Trajnime	Trajnere
Fetije Smakaj	Trajnime	Trajnere
Debatik Hoxha	Trajnime	Trajner
Arben Gashi	Trajnime	Trajner
Vjollca Zeqiri	Trajnime	Trajnere

Lista e Mentorëve dhe ToT të trajnuar nga IADK me mbështetjen e SDC-së

Emri & Mbiemri	Komuna	Edukimi
Mirjeta Rustemi	Rahovec	Master, Blegtori
Burim Rexhaj	Istog	Master, Hortikulturë
Mahir Dauti	Dragash	Bachelor, Hortikulturë
Shpetim Berisha	Vushtri	Master, Blegtori
Kimete Isufi	Prishtinë	Master, Blegtori
Ibadete Krasniqi	Prishtinë	Master, Blegtori
Xhavit Shala	Vushtri	Master, Blegtori
Armanda Jahja	Prishtinë	Bachelor, Agroekonomi
Skender Fejzullahu	Vushtri	Master, Hortikulturë
Besnik Imeri	Dragash	Bachelor, Hortikulturë
Hysnije Mikullovc	Mitrovicë	Master Hortikulturë
Magbule Hyseni	Prishtinë	Agronomi
Jeton Bajrami	Mitrovicë	Master, Hortikulturë
Mehedi Mulaj	Pejë	Agronom
Nevzad Maliqi	Kamenicë	Master, Agronomi

Adresa:
Rr. Ulqini Nr. 74.
40000 Mitrovicë
Kosovë

www.iadk.org
info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 530 308
Cel: +377 (0) 44 198 056

